

## STATUTI

### I SHOQËRISË TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### “BEST GERMAN BRANDS”

Në bazë të ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, dhe ligjit 9723, date 03.05.2007 “Për Qendren Kombetare të Regjistrimit”, me vullnetin e lire të ortakeve:

#### FORMIMI I SHOQËRISË

##### Neni 1

Formohet shoqëria e quajtur “BEST GERMAN BRANDS” me ortake :

1-Z.Niklovan Celalindur me 18.05.1980 ne Lushnje dhe banues ne Lushnje , me nr karte identiteti nr I00518190V me zotesi te plot juridike per te vepruar .Formohet shoqëria e quajtur “BEST GERMAN BRANDS” ortaket i vetem :

#### QENDRA E SHOQËRISË

##### Neni 2

- Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresen:Tirane, njesi administrative Kashar,Rruga Kostandin Kristoforidhi, zona Kadastrale 2679,Nr.pasurie 79/125. Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë vendin ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ate te vendeve te tjera ku mund te hapen dege te saj.Administrator i shoqerise eshte Z.Niklovan Cela lindur me 18.05.2018 ne Lushnje dhe banues ne Lushnje , me karte identiteti nr personal I00518190V.

##### Neni 3

Shoqeria “BEST GERMAN BRANDS” e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentet e krijimit te saj.

Shoqeria “BEST GERMAN BRANDS” eshte person juridik shqiptar.Ajo fiton te drejten e personit juridik nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

#### KOHEZGJATJA E SHOQERISE

##### Neni 4

Shoqeria“BEST GERMAN BRANDS” krijohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje kohezgjatje mbi 2 vjet. Shoqeria“BEST GERMAN BRANDS”mund te zgjate afatin e veprimtarise se saj ose mund ta mbylle aktivitetin e saj para ketij afati,sipas dispozitave qe percaktohen ne kete statut dhe sipas kriterëve qe percaktohen nga legjislacioni ne fuqi.

##### Neni 5

Shoqeria“BEST GERMAN BRANDS” per detyrimet qe do te lindin gjate aktivitetit te saj me te tretet,pergjigjet vetem me pasurine e saj.Ortaket e kesaj shoqerie nuk pergjigjen per detyrimet e kesaj shoqerie me pasurine e tyre qe nuk eshte futur ne kapitalin e kesaj shoqerie.



## OBJEKTI I VEPRIMTARISË EKONOMIKE I SHOQËRISË

### Neni 6

Shoqëria "BEST GERMAN BRANDS" do të ketë si objekt veprimtarie : Shitje vegla pune, servisi dhe materiale.

## MARREDHENIET EKONOMIKO-FINANCIARE

### KAPITALI THEMELTAR

#### Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë "BEST GERMAN BRANDS" përbehet nga numri i kuotave 1, në një vlerë prej 200.000 (dyqind mijë) leke, formuar dhe nënshkruar nga ortakët.

Kapitali zotërohet në këto mënyra:

-Z. Niklovan Celame datë lindje 18.05.1980 me numër kartë identiteti I00518190V, 100% të kapitalit themeltar;

Ortakët ka pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë legjitime. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

#### Neni 8

Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar në teresi ose veçanti, për një ose disa ortakë bëhet me vendim unanim të të gjithë ortakëve.

Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen në një regjistër të veçantë.

#### Neni 9

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të leverdivë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancin e saj. Bilanci i aktivitetit të shoqërisë duhet të përfundojë brenda muajit mars të vitit pasardhës.

Bilanci i aktivitetit financiar mund të bëhet nga vetë ortakët ose nga ekspertë të caktuar prej tyre. Por në të gjitha rastet rezultati përfundimtar duhet të merret në shqyrtim nga asambleja e ortakëve, brenda nga dita e mbylljes së vitit financiar

#### Neni 10

Shoqëria krijon fondet e saj për zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit të saj, në përputhje me rregullat në fuqi. Përberja e fondeve, burimet financiare të tyre, caktohen nga asambleja e ortakëve.

#### Neni 11

Shoqëria i disponon plotësisht mjetet e saj financiare.

## TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

### Neni 12

Ortakët kanë të drejta kryesore të cilat ushtrohen nëpërmjet vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakëve:

-Të marrin pjesë në administrimin e veprimtarive ekonomiko-tregtare të shoqërisë, në përputhje me kontratën dhe statutin.

-Të kërkojnë dhe t'u japin të dhëna që kanë të bëjnë me gjendjen dhe veprimtarinë e shoqërisë si dhe të gjitha dokumentat e përpunuara nga shoqëria (bilanci, libra llogarie).

-Të bëjnë propozime dhe t'i paraqesin ato me shkrim administratorit dhe Asamblese së Shoqërisë.

-Të heqin dorë nga shoqëria në kushtet që përcaktohen në kontratë dhe në këtë statut.



### **Neni 13**

Ortakët kanë këto detyra kryesore:

- Te depozitohen kuotën e tyre ose kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe me vendimet e Asamblesë.
- Te marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga ata vetë.
- Te kryejnë detyrimet e ngarkuara nga Asambleja ose Administratori për realizimin e detyrave të shoqërisë dhe për vendimmarrje duhet të jenë shumica e ortakëve ose të pakten 50 plus 1 të ortakëve të shoqërisë.

## **ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQËRISË**

### **Neni 14**

Organi më i lartë vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

Në asamble marrin pjesë të gjithë ortakët me të drejtë vote sipas shumave të vena në kapitalin themelor të shoqërisë.

Asambleja e ortakëve vendos në lidhje me këto probleme:

- Miratoni bilanci vjetor të shoqërisë.
- Vendos për shtimin, pakesimin ose transferimin e kapitalit themelor.
- Emeroni dhe shkarkoni administratorin e shoqërisë.
- Bëni modifikimin në kontroll dhe statut sipas ecurive të shoqërisë.
- Vendos për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë ose shndërrimin e shoqërisë.

## **ADMINISTRIMI**

### **Neni 15**

Administratori i shoqërisë është Z.Niklovan Cela lindur më 18.05.2018 në Lushnjë dhe banues në Lushnjë, me kartë identiteti nr personal I00518190V, emërohet për një periudhë 5 vjeçare dhe ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emer dhe për llogaritë të shoqërisë në marrëdhëniet me personat e tretë.

Administratori nuk mund të kryejë vetëm ato detyra që i janë lënë për kompetencë Asamblesë së Ortakëve.

Shoqëria merr përsipër të gjitha pasojat që mund të vijnë nga veprimet e administratorit.

### **Neni 16**

Administratorët janë përgjegjës individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose ndaj personave të tretë, kur gjatë veprimeve të tyre shkelin ligjin, kontratën dhe statutinose për shkelje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

## **MARRËDHËNIET E PUNES**

### **Neni 17**

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislatcionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për demet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.



## **EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL**

### **Neni 18**

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithë aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Ortaket caktojne dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

## **VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

### **Neni 19**

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit. Viti I pare financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në RegjistrinTregtardë QKR. Dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

## **BILANCI DHE FITIMET**

### **Neni 20**

Veprimtaria ekonomike e shoqerise do te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar.Fitimi neto i realizuar nga aktiviteti i shoqerise do te ndahet ndermjet ortakeve ne proporcion me pjeset e tyre takuese ne kapitalin themeltar.

## **SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

### **Neni 21**

Kur shoqeria likujdohet plotesisht Asambleja cakton nje likuidator i cili paraqet bilancin e likujdimit.Pasuria e shoqerise,pasi shlyhen detyrimet e shoqerise,u ndahen ortakeve ne proporcion me kontributin e tyre ne kapitalin themeltar.

## **LIBRAT E SHOQERISE**

### **Neni 22**

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:

- 1) Libri i Ortakeve
- 2) Libri i Mbledhjeve
- 3) Libri i vendimeve te administratorit
- 4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel.

Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.



**MBYLLJA E AKTIVITETIT TE SHOQERISE**  
**Neni 23**

Veprimtaria e shoqerise pushon me mbarimin e afatit te percaktuar ne kontrate ne qofte se ortaket me vullnetin e tyre te lire nuk e zgjatin kete afat.

Ajo mund te pushoje veprimtarine e saj edhe para afatit te parashikuar ne kontrate kur per kete marrin vendim te gjithe ortaket.Veprimtaria e shoqerise pushon edhe ne ato raste kur ortaket vendosin shnderrimin e shoqerise nga P.J ne nje lloj shoqerie tjeter.

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**  
**Neni 24**

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite

Tregtare", Statutit dhe rregullores se brendshme te shoqerise.Çdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

Ky statut firmoset rregullisht nga ortaku i vetem i shoqerise:

**Lushnje me 02/06/2021**

**Z.Niklovan Cela**

Niklovan Cela 